

Editorial/

NE NUK JEMI TERRORISTË! NE NUK JEMI AS CHARLIE!

Nga Justinian Topulli



Duke parë këto ditë faqen zyrtare të gazetës apo revistës më të përfolur sot në botë, veç diciturave dhe sloganeve që mbushnin faqen e saj në ngjyrë të zezë, të binte në sy vizatimi i një dore, e cila mbante të shtrënguar një laps të madh. Tipizimi i grushtit dhe mënyrës së kapjes së lapsit, me përmasa jo reale për të shkruar nga ajo dorë, të përçon mesazhin e qartë se lapsi është arma e tyre. Mënyra e pasqyrimin ishte tipike majtiste marksiste dhe të kujtonte parullat e PPSH-së, ku në një dorë mbahej edhe kazma edhe pushka.

Lapsi është një mjet shkrimi që mbahet me dy apo tre gishta, dhe përgjithësisht është shumë më elegant sesa mbajtësit e tij, ndërsa lapsi i gazetës në fjalë nuk ishte thjesht një laps, por një armë! Dhe arma vret! Lapsi që vret! Lapsi merr jetë njerëzish, ashtu si edhe pushka! Kjo nuk është aspak çudi, nëse në mendje na vjen ajo fjala e urtë shqiptare, se gjuha kocka s'ka, por kocka thyen.


Një armë e fjalës së lirë, do të thoshin në kor shumë njerëz!

Ndoshta ky është refreni më bajat dhe më i pavend që dëgjon këto ditë ngado. Një fjalë e lirë që nxit urrejtje, që fyen, ofendon, shan, përdhos, përçudnon, shpif, denigron dhe përbalt, atë që njerëzit kanë më të shenjtë se jeta e tyre. Kjo lloj fjale e lirë, për disa është më e shenjtë sesa shenjtorët më të mëdhenj të botës, më e shenjtë sesa vetë Zoti, më e shenjtë sesa çdo shenjtëri që mund të ekzistojë! Pra, as më shumë e as

më pak, por një hyjni më vete! Një idhull që vret për të lartësuar kultin e tij dhe përdhosur të tjerët, madje në fund martirizon edhe veten, për t'u ngritur mbi çdo shenjtëri tjetër! Ky është kulti i dhunës, që përçon dhunën, edukon dhunën dhe e provokon atë dhe simboli i tij është lapsi, që rroket si armë.

Dikush që lexon këto fjalë, menjëherë ndoshta do të thotë se ti je pro vrasjeve dhe justifikon atë që ndodhi, me këto që thua! Në fakt, kjo është vetë logjika që përçojnë kultet e dhunës, nëse nuk je me ne, je kundra nesh, nëse nuk je me të vrrarin, atëherë je me vrasësin! Jo, ne nuk jemi as me vrasësin dhe as me të vrrarin. Refuzojmë të bëhemi përkrah njërit apo tjetrit, sepse bota nuk është bardhë e zi, dhe se jeta ka edhe të tjera ngjyra. Ne nuk jemi terroristë, ne nuk jemi as charlie!

Justinian Topulli
 Kryetar i LHSH



Në datën 23 Janar të këtij viti, ndërroi jetë Shërbyesi i dy Xhamive të Shenjta, mbreti i Arabisë Saudite Abdullah ibn Abdulaziz al Saud - Allahu e mëshiroftë. Lidhja e Hoxhallarëve të Shqipërisë, në emër të stafit drejtues dhe anëtarëve të saj shpreh ngushëllimet e saj për familjen mbretërore dhe popullin e Arabisë Saudite, si dhe e lusim Allahun e Madhërisëm që ta përfshijë të ndjerin në mëshirën e Tij. Gjithashtu e lusim Allahun t'i japë mbarësi dhe sukses, në atë çfarë e kënaq Allahun, princit të kurorës, sot mbret i Arabisë Saudite, Selman ibn Abdulaziz al Saud, në udhëheqjen e vendit drejt zhvillimit dhe prosperitetit. Të Allahut jemi dhe tek Ai do të kthehemi.

Fq. 2/ Pyetje - përgjigje

.....Përgatiti: Lidhja e Hoxhallarëve të Shqipërisë

Fq. 4/ Të ushqehemi hallall

.....Përgatiti: Lidhja e Hoxhallarëve të Shqipërisë

Fq. 5/ Enver Hoxha dhe lufta kundër fesë

..... Nga Roald A. Hysa

Fq. 6/ Islami dhe fjala e lirë: ç'është aq për të qeshur?

..... Nga Sharif Nashashibi

PYETJE - PËRGGJIGJE

Ushqimet dhe medikamentet që lejohen dhe ndalohen në vendet joislame

Asambleja e Juristëve Muslimanë të Amerikës

Deklarata Përfundimtare e Sesionit të Tetë të Imamëve, zhvilluar nga Asambleja e Juristëve të Sheriatit në Amerikë, e mbajtur në Los Angeles – Kaliforni.

Rekomandimet e Akademisë në sesionin e saj të nëntë të trajnimit, të zhvilluar në Los Angeles në Janar të 2012 me titullin:

Cilat janë ushqimet dhe medikamentet që lejohen dhe ndalohen jashtë vendeve Islame

Lavdërimi i takon Allahut, paqja dhe bekimi i Tij qoftë për të Dërguarin e Allahut, familjen dhe shokët e tij dhe për të gjithë ata që e pasojnë atë.

- Në bazë të rregullave normative islame kafshët që theren nga myslimanët, të krishterët dhe çifutët janë të lejuara, kjo normë vlen në mënyrë permanente përderisa të provohet e kundërta.

- Që kafsha e therur të jetë hallall duhet të plotësohen këto kushte: të thuhet “Bismilah” gjatë therjes, therja të jetë e rregullt, kasapi duhet të jetë mysliman ose çifut ose i krishterë, kafsha e therur duhet jetë kafshë që lejohet ngrënia e mishit të saj.

- Thënia e emrit të Allahut gjatë therjes (Bismilah) është kusht që kafsha e therur të konsiderohet hallall, ai mysliman që duke e ditur këtë dispozitë-kusht nuk e praktikon atë -duke qenë i vetëdijshëm- atëherë therja e tij nuk konsiderohet hallall. Ndërsa ai që nuk e thotë fjalën “Bismilah” -për shkak të padijes apo harresës- e therura e tij është hallall. Për sa i përket therjes që bëhet nga të krishterët apo çifutët, nuk është kusht që ata të përmendin “Bismilah” që therja e tyre të jetë hallall. Ai që e ther kafshën në emër të dikujt tjetër veç Zotit, ky mish nuk është hallall, edhe nëse ky person është mysliman apo i krishterë ose çifut. Nëse therjet bëhen në grup (me makineri) atëherë mjafton thënia e fjalës “Bismilah” njëherë për çdo grup dhe nëse ajo

ndërpritet atëherë fjala “Bismilah” duhet të përsëritet.

- Çdo njeri që konsiderohet mysliman therja e tij është hallall, sado i keq apo bidatçi të jetë ai njeri, vetëm nëse ky njeri arrin deri në kufër që të nxjerr nga feja, atëherë kafsha që ai ther nuk është hallall. Çdo kush që konsiderohet mysliman edhe pse pjesëtar i sekteve të devijuara, kafsha që ai ther është e lejuar, me përjashtim të rasteve kur personi konkret ka një bidat që e nxjerr atë nga feja, në këtë rast vetëm therja e këtij personi nuk lejohet të hahet.

- Zbatimi i rregullave të therjes është kusht që kafsha e therur të jetë hallall, kjo do të thotë se gjatë therjes, që duhet të rrjedhë gjak, duhen prerë venat e gjakut, kjo për kafshët që është e mundur të theren, dhe me goditje gjakërrjedhëse për kafshët që nuk kapen dot, e shoqëruar kjo në të gjitha rastet me përmendjen e emrit të Allahut dhe me nijet për therje.

- Therja është metoda e preferuar nga ana e Sheriatit për prerjen e deleve, lopëve, shpendëve dhe kafshëve të tjera të ngjashme me to. Prerja bëhet në fyt, më e plotë është kur gjatë saj prihet kanali i ushqimit, i frymëmarrjes dhe dy venat e gjakut. Më e pakta vlen therja që shkakton rrjedhjen e gjakut duke prerë kanalën e ushqimit dhe njërin prej venave të gjakut. Kushtëzohet që gjatë therjes mjeti me të cilën ai kryhet të jetë i prehtë dhe të presë për shkak të tehut të tij, qoftë ky material prej hekuri apo diçka tjetër, me përjashtim të rasteve kur materiali është kockë apo thua, të cilat nuk lejohen të përdoren për këtë qëllim.

- Goditja me pasojë vrasjen (akr) e kafshës, në cilëndo pjesë të trupit, duke shkaktuar rrjedhje gjaku, praktikohet për kafshët e gjahut që nuk mund të kapen. Këtë gjykim kanë si kafshët që jetojnë në gjendje të egër dhe që lejohet ngrënia e tyre ashtu edhe për kafshët e buta shtëpiake nëse ato sillen si të egra. Nëse kafsha kapet e gjallë atëherë ajo duhet të theret.

- Nuk lejohet torturimi i kafshës para se ajo të theret, duke përdorur goditje elektrike apo fizike etj, përveç rasteve të pamundësisë kur kjo bëhet për të vënë nën kontroll kafshën që do të theret. Teprimi në të tilla raste -përtej së nevojshmes- është i ndaluar. Nëse kafsha ngordhë nga një veprim i tillë -para se ajo të theret- atëherë

ajo konsiderohet e ngordhur dhe nuk lejohet të hahet.

- Si normë bazë therja e pulave apo kafshëve të tjera bëhet nga dora e njeriut, por lejohet që kjo therje të bëhet edhe me anë të makinerisë, nëse përmbushen kushtet e therjes së lejuar fetarisht.

- Nuk është e pëlqyer që t'i hiqet koka kafshës së therur menjëherë pas therjes së saj, sepse pa qenë e nevojshme kjo i shton asaj edhe më shumë dhimbje para ngordhjes. Dijetarët nuk e shohin të pëlqeshme prerjen e ndonjë pjesë të trupit të kafshës së therur para se ajo të jap shpirt plotësisht, por gjithsesi ky mish edhe nëse theret në këtë mënyrë lejohet ngrënia e tij.

- Çdo therje e mishit që mbikëqyret nga myslimanët ose çifutët (koshar) në origjinë ky mish është i lejuar, sido që të bëhet therja kokë për kokë, apo në grup me makineri.

- Duke përjashtuar therjet që bëhen nën mbikëqyrjen e myslimanëve ose çifutëve (koshar), shumë prej mishrave që theren në këtë vend (SHBA) ka dyshime për to. Disa nga këto dyshime lidhen me mënyrën e therjes, ku lopët apo delet theren duke u prerë shumë poshtë fytyrës në mjaft thertore dhe verifikimi është i pasigurt në mjaft raste, nëse therja është në përputhje me rregullat islame apo jo. Dyshime të tjera lidhen me trulllosjen e kafshëve, ku një përqindje e caktuar ngordh para se ato theren, në veçanti në mes lopëve dhe deleve. Kjo përqindje ndryshon sipas thertoreve të ndryshme, duke e përzierë kështu mishin e ngordhur me atë të therur. Dyshime të tjera kanë lidhje me përzierjen në mes ithtarëve të Librit me të tjerë që nuk janë të tillë, natyrisht që kjo përqindje ndryshon nga një shtet në tjetrin, çka e bën tepër të nxituar vendimin se ky mish është tërësisht hallall. Dyshimet që lidhen me këtë pikë janë më të forta kur kemi të bëjmë me delet dhe lopët, sepse ato theren mbi gjoks në mënyrë të atillë që

të fut në dyshime. Janë pikërisht këto raste në të cilat janë konstatuar në disa thertore përqindje të larta ngordhesh, e ku më pas ato përzihen me kafshët e therurat, sepse në këtë rast nuk ka ndonjë ligj që detyron largimin e këtyre kafshëve që ngordhin nga trulllosja para se ato të theren. Kështu që në të tilla raste mendimi se një mish i ardhur nga këto thertore nuk duhet të konsumohet është mjaft i fortë, sepse kështu i largohemi dyshimit dhe jemi më të sigurt nga ana fetare. Kjo dilemë është më e dobët në rastet e pulave, sepse ato theren në fyt dhe trulllosja e tyre shumë rrallë shkakton ngordhje, çka na bën të themi se tolerohet ngrënia e pulave apo shpendëve që shiten nëpër tregjet publike. Natyrisht porta e ruajtjes së vetvetes (el-uera) është e hapur dhe e pëlqyer për këdo që do tu qëndrojë larg opinionëve mospajtuese për këtë çështje, si dhe niset nga qëndrimi për të qenë në rregull në çështjen e mishit ku shumica e dijetarëve e ndalojnë përdorimin e tij nëse rreth tij ka dyshime të qenësishme. Në këtë rast del në pah rëndësia e mbështetjes, që u duhet dhënë kompanive që prodhojnë mish hallall, duke ndihmuar në ngritjen e tyre dhe mesazhit që ato kumtojnë dhe duke e konsideruar punën e tyre si vazhdimësi të mesazhit që japin xhamitë dhe shkollat islame.

- Njerëzit që identifikojnë veten e tyre si ithtarë të Librit njihen si të tillë, mjafton që ata në përgjithësi ta konsiderojnë veten si ndjekës të krishterimit apo judaizmit, dhe nuk ka rëndësi fakti se ata kanë devijuar apo deformuar fenën e tyre, sepse në të njëjtën gjendje kanë qenë edhe kohën e Profetit (alejhi salatu ue selam) dhe para tij, dhe megjithatë do të shohim se Kurani famëlartë u drejtohet atyre me emrin “ithtarë të Librit”. Ky gjykim vlen në mënyrë të përgjithshme për SHBA dhe banorët e saj, me përjashtim të atyre thertoreve



MBLEDH ZEKATIN TUAJ

Për zekatin në lekë:
IBAN: AL 43 2051 6703 4163 29CL OTCL ALLB
Llogaria në lekë:
IBAN: AL 70 2051 6703 4163 29CL OTCL ALLA
Llogaria në Euro:
IBAN: AL 37 2051 6703 4163 29CL OTCF EURO
Llogaria në Dollarë:
IBAN: AL 81 2051 6703 4163 29CL OTCF USDA

Lidhja e Hoxhallarëve të Shqipërisë
Tel: 0672304520 /0672538334/048320160
BKT Banka Kombëtare Tregtare
Nr. i llogarisë : 52416329

Bordi botues:
Justinian TOPULLI
Genc PLUMBI
Mustafa TËRNIQI

LIDHJA HOXHALLARËVE TË SHQIPËRISË
Unaza e Re, Rruga: “Teodor Keko” Pallati Edglis, Tiranë-Shqipëri
lidhjahoxhallareve@yahoo.com
Tel & Fax: +355 (0)48320160
<http://www.lidhjahoxhallareve.com>

ku ata që merren drejtpërdrejtë me therjen prononcohen se nuk i përkasin ithtarëve të Librit ose i përkasin feve të tjera.

- Në origjinë mishi që theret në shtetet komuniste apo politeiste, njerëzit e të cilave nuk ndjekin ndonjë fe me origjinë qiellore, nuk është i lejuar derisa të provohet se ai që e ther mishin është mysliman ose prej ithtarëve të Librit.

- Restorantet kineze apo të politeistëve në shtetet e ithtarëve të Librit marrin të njëjtin gjykim si restorantet e tjera të këtyre vendeve, me përjashtim të rasteve kur dihet që këto restorante kanë thertore të veçanta, në këtë rast të therurat e tyre nuk lejohen, sepse nuk përmbushin kushtin që duhet të ketë kasapi.

- Gjahu i detit dhe ushqimi me origjinë detare është i lejuar. Të gjitha kafshët që jetojnë vetëm në det janë të lejuara, pa përjashtim të gjitha, të ngordhura apo të gjalla, ku futen edhe peshqit e egër (p.sh. peshkaqeni) etj. Argument për këtë është e përgjithshmja e fjalës së Allahut të Lartësuar: "Ju është lejuar gjuetia e detit dhe çdo ushqim nga deti" (el-Maide: 96)

- Nuk është e hijshme të hahet në restorante që ofrojnë ushqime të ndaluara, për shkak të ndalesave të dukshme që ka në to dhe që është e vështirë të mënjanohen, kjo për shkak frikës që ekziston se ushqimet e ndaluara mund të gatuhet në të njëjtat enë ku gatuhet edhe ato të lejuarat dhe se ato nuk lahen para përdorimit të tyre. Në të tilla raste domosdoshmëria dhe nevoja e përgjithshme merren në konsideratë me masën që i takon.

- Nuk lejohet përdorimi i enëve të jomuslimanëve para se ato të lahen, nëse dihet që ato janë të papastra, por nëse nuk dihet gjendja e tyre, atëherë norma bazë është se lejohet përdorimi i tyre.

- Tymi që del nga djegia e sendeve të papastra konsiderohet –sipas mendimit më të saktë- i pastër, sepse papastërtia është tjetërsuar nga djegia, ndaj nuk ka asnjë problem. Përdorimi i mikrovalës për ngrohjen e ushqimeve është i lejuar edhe nëse para saj është ngrohur një ushqim jo i lejuar.

- Si normë bazë ngrënia së bashku me njerëz që janë duke ngrënë apo pirë ushqime të ndalura nuk lejohet, si p.sh. mish derri apo pije dehëse -edhe pse myslimani pjesëmarrës në të tilla sofrat nuk konsumon të tilla ushqime haram. Përjashtim bëhet në raste domosdoshmërie pune apo nevojë të përgjithshme, ku mospjesëmarrja në të tilla sofrat ka pasojë për atë që nuk merr pjesë, por natyrisht këtu domosdoshmërisë i jepet vendi që i takon pa kaluar cakun, e duke u munduar sa më shumë shmangien e prezencës apo pakësimit në saj.

- Nuk është e hijshme që mysafiri

të pyesë të zotin e shtëpisë nëse ushqimi që po i servir është hallall apo jo, nëse personi në fjalë është njeri i besueshëm, ose nuk dihet për të se nuk i respekton rregullat e fesë së Zotit, duke i besuar kështu anës së dukshme të tij. Në raste kur ka siguri se ushqimi i ofruar nga i zoti i shtëpisë bie ndesh me mendimin e mysafirit që nuk e sheh atë si hallall, në këtë rast është e hijshme që refuzimi të bëhet sa më butësisht, duke qenë se mospajtimi i opinioneve për sa i përket mishit të therur nga ithtarët e Librit në kohën e sotme është një çështje që hyn te ixhtihadet që merren në konsideratë.

- Lejohet të pyetet tregtari për llojin e mishit që shet, sepse çdo lloj ka klientët dhe koston e tij.

- Lejohet përdorimi i xhelatinës që nxirret nga lëndët e lejuara, nga kafshët e lejuara, të therura sipas normave fetare. Nuk lejohet përdorimi i xhelatinës që nxirret nga ato që janë haram si: lëkura dhe kocka e derri, si dhe nga çdo kafshë apo lëndë tjetër e ndaluar. Nuk lejohen të përdoren as ushqimet që përmbajnë lëndë të tilla, me përjashtim të rasteve kur masa është shumë e vogël dhe është shpërbërë në një lëndë tjetër, ose është transformuar më parë nga një lëndë në një lëndë tjetër.

- Transformimi (el-istihale) quhet shndërrimi i një sendi në një send tjetër duke ndryshuar në veten dhe cilësitë e saj. Kjo është një formë e pastrimit të gjërave, duke i shndërruar sendet e papastra ose të ndotura në sende të pastra, si pasojë e kësaj ndryshon edhe gjykimi nga të qenit haram në hallall, sepse gjykimi lidhet me emrin dhe cilësinë e objektit dhe lidhet me praninë ose mosekzistencën e tij. Por, nëse cilësitë e objektit ndryshojnë dhe realiteti ngelet, gjykimi nuk ndryshon, si p.sh. në rastin kur diçka e lëngshme bëhet e ngurtë apo e kundërta, sepse lëngëzimi apo ngurtësimi edhe pse ndryshon disa cilësi nuk e ndryshon realitetin. Çështja është problematike kur kemi të bëjmë me zbatimin e kësaj gjëje në aspektin praktik sesa atë teorik nga ana juridike fetare, ndaj kjo çështje më së shumti i përket të vlerësohet nga specialistët e fushës sesa nga dijetarët islamë.

- Lëndët ushqimore, të cilat në përbërjen e tyre kanë dhjam derri të patransformuar në diçka tjetër, si p.sh. në disa lloje djathërash, vajrash, kremrash, biskotash dhe çokollatash, janë të ndaluara dhe nuk lejohet ngrënia e tyre, për shkak se dijetarët islam janë unanim në mendimin se derri është kafshë e papastër dhe nuk lejohet ngrënia e tij, dhe në këtë rast nuk ka asnjë domosdoshmëri në konsumimin e këtyre ushqimeve.

- Nuk lejohet që gjatë gatimit të përdoren pije dehëse, qoftë kjo në masë të vogël apo të madhe, sepse nuk ka ndonjë nevojë apo domosdoshmëri

për këtë gjë, që nëse nuk konsumohet dëmtohet diçka. Ajo që e ka lejuar Allahu dhe i Dërguari i Tij është e mjaftueshme, kështu që shija që kërkohet t'i jepet ushqimit gjatë gatimit nëpërmjet përdorimit të pijeve dehëse mund të zëvendësohet me lëndë të tjera edhe më të mira dhe që janë të lejuara.

- Gjykimi për sa i përket ushqimeve ku është përdorur pije dehëse gjatë gatimit të tyre ndryshon sipas rastit: nëse gjurmët e tij ndjehen, si p.sh. dehje e atij që e konsumon, ndryshim i shijes së ushqimit ose ngjyrës, në këtë rast ky ushqim është i ndaluar. Por, nëse përmbajtja e pijes dehëse ka avulluar plotësisht dhe nuk ka ngelura asnjë gjurmë në ngjyrë, shije, erë apo dehje, ky lloj ushqimi ngelet hallall edhe pse mendimi se alkooli ka avulluar plotësisht dhe nuk ka lënë asnjë gjurmë është në realitet e vështirë të thuhet, pa harruar këtu faktin se ngrënia e këtij ushqimi nënkupton aprovim të përdorimit të pijes dehëse në të, çka është gjynah më vete, kështu që ky ushqim hyn tek ushqimet që është i paqartë gjykimi për to, ndaj këshillohet largimi prej tyre për të qenë të qenë në rregull fetarisht.

- Nuk lejohet përzjerja e qëllimshme e ushqimeve dhe barnave me lëndë dehëse, cili do qoftë qëllimi: shija, aroma apo çfarëdo arsye tjetër. Lejohet përdorimi i tyre si dhe shitblerja nëse ato përmbajnë sasi të pakët që shpërbëhet pa u shfaqur ndikimi i tyre në ngjyrën e ilaçit ose ushqimit, në shijen, erën e tyre si dhe nuk shkakton dehje për atë që e përdor. Në këtë rast kjo lëndë shpërbëhet duke u përzjerë në diçka të pastër dhe të lejuar ndaj hyn në diçka të tolerueshme, por këtu duhet të theksojmë se, nuk i lejohet myslimanit të prodhojë diçka të tillë, qoftë ky ushqim ose ilaç që konsumojnë myslimanët dhe as të japë ndihmesën e tij në këtë drejtim, në asnjë lloj aspekti.

- Ushqimet që janë të dëmshme për shëndetin nuk janë hallall edhe pse ato mund të jenë të pastra, kjo sepse feja e ndalon të dëmshmen, cilido qoftë ai që preket prej saj. Lëndë të tilla janë p.sh. helmet – me përjashtim të rasteve kur ato përzihen në ilaçe për arsye kurimi gjë që lejohet- ose lëndë që shkaktojnë dëme tek disa njerëz, si p.sh. në rastet kur disa të sëmurëve u ndalohen disa ushqime, sepse ato janë të dëmshme posaçërisht për ta, në këtë rast për ta nuk lejohet konsumi i tyre, për shkak të dëmit që ato u shkaktojnë atyre.

- Nuk është e pëlqyeshme të konsumohen ushqime apo pije që u ndjehet shija e pijeve dehëse në to edhe pse këto ushqime nuk të dehin, për t'i mbyllur kështu rrugën "nënës së të këqijave" dhe çdo kontakti me të, e që mund të ndjell dëshirën për përdorimin e saj, ose krijon përngjasim

me njerëzit që e konsumojnë atë. Në këtë gjykim kemi pasur parasysh urdhrin fetar për t'iu larguar pijeve dehëse fizikisht dhe mendërisht.

- Origjina dhe norma bazë për ushqimet është se ato janë të lejuara, ndaj asnjë prej tyre nuk mund të konsiderohet si haram nëse për të nuk ka argument. Uthulla është ushqim si gjithë të tjerat dhe merr gjykimin e tyre normativ. Dihet se Profeti (alejhi salatu ue selam) e ka konsumuar uthullën, madje edhe e ka lavdëruar atë dhe Profeti nuk mund të lavdëroj një ushqim të papastër apo të ndaluar. Uthulla e nxjerrë nga frutat është e lejuar, përderisa origjina e saj vjen nga frutat edhe pse gjatë procesit të shndërrimit ajo kalon në pije dehëse, por nuk është ky qëllimi i saj, pasi ky është një proces që e kërkon natyra e shndërrimit të saj në uthull. Të gjitha uthullat që prodhohen nëpër fabrika duhet ta kalojnë këtë proces, pra para se të bëhet uthull kjo lëndë ushqimore fillimisht kalon në procesin e alkoolizimit e më pas në uthull. Këtu jemi në gjendje të vëmë re dallimin në mes këtij lloji dhe llojit i cili ka qenë që në fillim të procesit pije dehëse e ndaluar dhe përdorej si e tillë dhe më pas është marrë për tu shndërruar në uthull, pikërisht ky lëng nuk vlen të përdoret, me përjashtim të rasteve kur ai bëhet uthull vetë, sipas mendimit më të saktë të dijetarëve për këtë çështje.

Burimi:

<http://amjaonline.org/2012/04/>



Lidhja e Hoxhallarëve të Shqipërisë
رابطة أئمة ألبانيا
The Albanian Imam's League



www.lidhjahoxhallareve.com
Adresa: Rr. Teodor Keko (Unaza e Re)
P. Egllis, Kati III, Tirana-Albania
Mob1: 00 355 672304520
Mob2: 00 355 672753789
E-mail: lidhjahoxhallareve@yahoo.com

Të ushqehemi Hallall

Allahu i Lartësuar thotë në Kuran:

“O besimtarë! Hani nga ushqimet e lejuara që ju kemi dhënë.” (El-Bekare: 172)

“Është e ndaluar për ju ngrënia e së ngordhurës, e gjakut, e mishit të dërrit, e mishit të kafshës që është therur jo në emër të Allahut, e mishit të kafshës së mbytur lidhur në fyt, e mishit të kafshës që është rrahur dhe ka ngordhur, e mishit të kafshës që është vlarë nga rrëzimi apo nga brrirët e kafshëve të tjera, e mishit të asaj që është kafshuar nga egërsirat - përveç atyre që i therni ju para se të ngordhin. Gjithashtu, është e ndaluar për ju edhe ngrënia e mishit të kafshëve që janë therur për nder të idhujve apo për të kërkuar fatin në fall. Të gjitha këto që u përmendën, janë gjynah.” (El-Maide:3)

“O besimtarë! Me të vërtetë, pijet alkoolike, bixhozi, idhujt dhe shigjetat e fallit janë vepra të ndyta nga punët e djallit. Prandaj, largohuni nga këto, me qëllim që të shpëtoni!” (El-Maide: 90)

E ndërsa i Dërguari i Allahut **“ndaloi çdo egërsirë me dhëmbë copëtues dhe çdo shpend me kthetra.”** (Muslimi nr. 1934)

Këto ajete Kuranore dhe ky hadith profetik, janë disa nga argumentet bazë të normativës islame, mbi të cilat mbështet parimi i ushqimit të lejuar ose ndryshe hallall. Nisur nga rëndësia fetare që ka të ushqyerit hallall, Zoti në shpalljen e Tij hyjnore, ku këtu përfshihen edhe fjalët e Profetit, ka sqaruar se çfarë është ushqimi hallall dhe ai haram. Ushqimi hallall, pra i lejuar, përkufizohet në mënyrë të përgjithshme dhe i pakategorizuar, ai është çdo gjë e mirë dhe e dobishme për njerëzit, ndërsa ushqimi haram, pra i ndaluar, përkufizohet nëpërmjet përjashtimit të kategorizuar dhe të specifikuar, si në ajetet dhe hadithin e mësipërm. Kjo sepse, ushqimet e ndaluara janë shumë pak, në dallim me ato të lejuara të cilat janë të panumërta, kështu që për këtë arsye ushqimet haram specifikohen me emra dhe kategori dhe çdo gjë tjetër më pas konsiderohet si hallall. Natyrisht që në të Drejtën Islame, e për rrjedhojë në librat e dijetarëve muslimanë, ka sqarime të hollësishme rreth kësaj teme. Ndërsa këtu ne paraqitëm vetëm disa prej argumenteve kryesore, sa për të treguar rëndësinë që Islami i tregon këtij aspekti shumë të rëndësishëm të jetës njerëzore, madje të domosdoshëm, e që është ushqimi.

Ushqimet pra, në këndvështrimin islam nuk shihen vetëm nga aspekti i tyre shëndetësor, por edhe ai fetar,

aspekt ky i cili kërkon mbikëqyrje të vazhdueshme që duhet të respektohet nga prodhuesit e tij. Dihet se muslimani në përgjithësi është i kujdesshëm që ushqimi i tij të jetë hallall, por ai që i hedh një vështrim tregut ushqimor në kohën e sotme dhe realitetit të konsumatorëve muslimanë sheh se shpesh ata hezitojnë për çështjen e ushqimeve të eksportuara nga vendet joislame, e madje edhe nga disa prodhues muslimanë vendas, kjo për shkak të larmisë së burimeve të ndryshme për lëndën e parë që përdoret për prodhimet ushqimore apo edhe për shkak të padijes dhe papërgjegjshmërisë në raste të tjera.

Shumë prej muslimanëve dyshojnë rreth vërtetësisë së fjalëve “hallall” që shtypen dhe ngjiten në produktet e mishit, apo vihen si etiketime nga aktivitet tregtare që ofrojnë këtë shërbim, por edhe në vërtetësinë e certifikatave të therjes sipas mënyrës islame, që ndonjëherë jepen nga njerëz të panjohur, dhe ndonjëherë edhe nga organizma joislame. Një problem tjetër gjithashtu janë edhe përbërësit e këtyre produkteve, a kanë ato burime bimore apo shtazore të lejuar fetarisht. Muslimanit i kërkohet që të jetë i kujdesshëm me ushqimin e tij në mënyrë që ai të mos vijë nga burime të ndalura.

Përcillet nga njëri prej shokëve të Profetit, se i Dërguari i Allahut (alejhi salatu ue selam) ka thënë: **“Zjarri do prekë më së pari atë pjesë trupit që është rritur nga harami.”** (Tirmidhi)

Përse ushqimi hallall?

Ngrënia e ushqimit të mirë e hallall ka ndikim të madh në pastërtinë e zemrës, në përgjigjen e lutjes dhe pranimin e adhurimit, ashtu siç edhe ngrënia e haramit bëhet pengesë për pranimin e tij. Allahu i Lartësuar thotë për njerëzit e devijuar: **“Këta janë të asaj dore të cilët Allahu nuk dëshiron t’ua pastrojë zemrat. Për ata, në këtë jetë ka poshtërim, kurse në jetën tjetër ka ndëshkim të rëndë. Ata janë dëgjues të gënjeshtres dhe e hanë me kënaqësi të madhe atë që është e ndaluar.”** (El-Maide: 41, 42) Pra atë që është haram. Ai që ushqehet me haram Allahu nuk ka sesi t’ia pastrojë zemrën dhe as nuk do t’i përgjigjet lutjes së tij! Profeti (alejhi salatu ue selam) ka thënë: **“O ju njerëz! Allahu është i mirë dhe pranon vetëm të mirën. Allahu i ka urdhëruar besimtarët ashtu siç i ka urdhëruar Profetët, Ai ka thënë: “O të dërguar! Hani nga të lejuarat dhe bëni vepra të mira!”** (El-Muminun: 51) dhe ka thënë: **“O besimtarë! Hani nga ushqimet e lejuara që ju kemi dhënë”** (El-Bekare:172) më pas ai (Profeti) përmendi një njeri që

udhëton gjatë, i pluhurosur dhe me flokë të shpupuritur, i cili ngre duart e tij lart drejt qiellit dhe thotë: **O Zot! O Zot! Dhe ndërkohë ushqimi i tij është haram dhe pija e tij është haram dhe veshja e tij është haram dhe është ushqyer me haram, e si atëherë do t’i përgjigjet atij për çka lutet?!”** (Muslimi)

Allahu i Madhëruar e di gjendjen e krijesave të Tij dhe se për çfarë ata kanë nevojë dhe se çfarë u bën atyre dobi dhe dëm, Ai për këtë i ka shpallur robët dhe të Dërguarit të Tij Muhamed (alejhi salatu ue selam) ligjin islam, që përmban të gjitha të mirat dhe parandalon të gjitha të këqijat. Allahu i ka ndaluar haramet për shkak të dëmit që ato u bëjnë njerëzve. Një prej këtyre harameve është edhe mishit i dërrit dhe dhjami i tij, po ashtu mishit i kafshëve që hahen siç janë: pulat, lopët, e dhentë, nëse ato nuk theren sipas kërkesave që përmban ligji islam. Allahu i Lartësuar thotë: **“Thuaj: “Unë nuk gjej në atë që më është shpallur mua, asgjë që e ndalon njeriu të hajë çfarë të dojë, përveç kafshëve të ngordhura, gjakut të derdhur, mishit të dërrit – se këto janë të ndyta – dhe mishit që është therur në emër të tjetërkujt e jo në emër të Allahut.”** (El-Enam: 145) Disa prej dijetarëve kanë pohuar se umeti islam është unanim për sa i përket ndalimit të dërrit dhe të gjithë pjesëve të tij.

Allahu i ka ndaluar gjërat e këqija për urtësi të mëdha, të cilat i di Ai edhe pse disa prej tyre mund të jenë të panjohura për njerëzit. Nëse njerëzve do tu bëheshin të qarta disa të fshehta dhe urtësi pse Allahu i ka ndaluar disa gjëra, nuk kishin për të hezitur t’i përmbaheshin vetëm ushqimit hallall, e ajo që nuk dinë njerëzit është më e madhe. P.sh, arsyeja pse Allahu e ka ndaluar dërrin – e Zoti e di më së miri- është ndyrësia e tij, dëmi dhe sëmundjet fizike e shpirtërore që lë të njeriu, kjo sepse ushqimi i tij i preferuar janë ndyrësirat dhe papastërtitë. Ai është i dëmshëm dhe i ndaluar në çdo vend dhe në çdo kohë, pa dallim. Ngrënia e mishit të dërrit p.sh. shkakton marrjen e të vetmit krimb vrasës që është “trichinosis”. Po kështu dëmi të ngjashme mund të përmenden edhe për konsumin e kafshëve të ngordhura, për pijet dehëse etj. Ajo çka është e rëndësishme në këtë mes është se një musliman, për të merituar këtë emër që ka, duhet t’i përulet Zotit të tij dhe përulja përmbushet kur ai respekton me të gjitha mundësitë njerzore urdhësat dhe ndalesat e Islamit, mes tyre edhe ato që kanë të bëjnë me ushqimin.

Nisur nga kjo rëndësi që paraqet ushqimi hallall dhe me dëshirën e mirë për ta vënë sa të jetë e mundur në shinat e duhura procesin e prodhimit dhe deklarimit të ushqimit

hallall, e për të siguruar sa më shumë të jetë e mundur konsumatorin musliman për këtë shërbim, Lidhja e Hoxhallarëve të Shqipërisë (LHSH) duke u mbështetur në standarde ndërkombëtare të certifikimit hallall ka përpunuar një standard të tillë për t’u zbatuar në Republikën e Shqipërisë. Për realizimin e këtij procesi në mënyrë sa më cilësore LHSH ka lidhur bashkëpunim me Albinspekt, një trup kontrolli kjo që ofron shërbime për Standardin Organik të Bashkimit Europian dhe e Akredituar nga Drejtoria Gjermane e Akreditimit.

Përse certifikimi hallall?

Është për t’u theksuar se, produktet hallall, për t’u certifikuar si të tilla, duhet të kalojnë në disa etapa që fillojnë me lëndën e parë, origjinën e saj, proceset e importit të kësaj lëndë, procesin e prodhimit, prodhimin, finalizimin e prodhimit dhe ambalazhimin, tregtimin dhe konservimin. Në këtë proces rëndësi marrin edhe përbërës të tjerë që kanë të bëjnë me ngjyrën, shijen, konservimin etj.

Për të gjithë këtë proces si dhe për t’iu gjendur sa më pranë besimtarëve muslimanë, prodhuesve dhe tregtuesve që shesin një produkt hallall, mendojmë, duke u nisur dhe nga boshllëku i madh që ekziston sot mbi proceset e mësipërme, të ofrojmë shërbimin “Certifikimi sipas Standardit Hallall” i cili do t’i shërbejë jo vetëm konsumatorëve muslimanë mbi produktet hallall, por dhe bizesit shqiptar, për mënyrën e prodhimit të këtij produkti si dhe tregtimit të tij.

Përfitimet e konsumatorëve:

- Garanci;
- Siguri;
- Kontroll;
- Identifikim.

Përfitimet e Kompanive prodhuese dhe përpunuese:

- Shtim i vlerës së produktit;
- Kënaqësia e klientit;
- Përmirësimi i imazhit;
- Diferencimi në treg;
- Mbrojtje nga abuzimet dhe falsifikimet;
- Besueshmëri.

Përgatiti

Lidhja e Hoxhallarëve të Shqipërisë

www.lidhjahoxhallareve.com



Enver Hoxha dhe lufta kundër fesë

nga Roald A. HYSÄ

Luftën kundër fesë ka nisur qysh në momentet e para të Luftës Nacional - Çlirimtare dhe kjo shihet në ekzekuti-met jo vetëm të kundërshtarëve politikë, por edhe të atyre hoxhallarëve, të cilët nuk pranuan të jenë me Frontin Nacional-Çlirimtar dhe nuk ranë pre e propagandës boshe “Të bashkohemi pa dallim krahine, feje, politike apo ideje”. Le të kujtojmë këtu Hoxhë Selim Brahjen e Saukut në Tiranë dhe të hoxhë Sait Shehut nga Vranjti i Kastriotit të Dibrës, të cilët u ekzekutuan publikisht nga partizanët e Frontit Nacional-Çlirimtar njëri në vitin 1943 dhe tjetri më 1944 akoma pa u marrë pushteti nga komunistët. Enver Hoxha si lideri i Shqipërisë komuniste qysh në ditët e para pasi mori pushtetin nisi të merrej me ata klerikë, të cilët ai i konsideronte si kundërshtarë dhe për pasojë ai i shpalli si shërbëtorë të pushtuesve dhe “armiqtë e popullit”, e lloj-lloj etiketimesh të tjera të kësaj natyre.

Ky etiketim vërehet në të gjitha dosjet gjyqësore të këtyre klerikëve, ashtu si edhe në dosjet e kundërshtarëve të tjerë, madje kur Hafiz Mustafa Varoshii bën rekurs vendimit të Gjykatës së shkaillës së parë shkruan në letren e tij “nga burgu i armiqve të popullit”. Enver Hoxha e ka pranuar luftën kundër fesë dhe spastrimet në radhët e klerikëve kundërshtarë në një fjalim publik të tij gjatë një ture vizitash në veri të vendit, e më konkretisht në Mirditë në shtator të vitit 1952. Në këtë fjalim ai ka folur për tre nga katër komunitetet e mëdha fetare në vend, duke vendosur lidhjet që kanë pasur me pushtuesin e egër turk 500-vjeçar myslimanët, ortodoksët me grekët e Fanarit dhe katolikët me Vatikanin. Është në ligjërimin e Enver Hoxhës, por edhe të gjithë udhëheqësve të tjerë të lartë të regjimit të flasin “Në emër të Popullit” dhe të dënojnë “Në emër të Popullit”. Ai shprehet haptas dhe qartë, kur thotë i spastruar armiq të tradhtarët brenda këtyre tre komuniteteve.

“Natyrisht besimtarët myslimanë spastruan nga radhët e tyre tradhëtarët klerikë myslimanë, që gjatë Luftës nacional-çlirimtare u lidhën me okupatorët, që u përpoqën të vazhdonin rrugën si në kohën e sulltanëve, këta herë në rrugën e fashistëve italianë e të gjermanëve. Feja myslimane në vendin tonë tash është e shkapitur nga çdo intrigë e armiqve të popullit, ajo s’ka më lidhje me ata që i bënin varrin popullit dhe atdheut tonë nën maskën e fesë.”

Natyrisht besimtarët ortodoksë spastruan nga radhët e tyre tradhëtarët klerikë ortodoksë, që gjatë Luftës nacional-çlirimtare u lidhën me okupatorët.

Klerikët reaksionarë të kishës katolike në Shqipëri edhe pas çlirimit të atdheut hynë në shërbim të Vatikanit dhe të padronit të tij, imperializmit amerikan, për të minuar pushtetin popullor në vendin tonë. Natyrisht, populli dhe pushteti i tij u dha grushtin e merituar këtyre tradhëtarëve.”

Si të gjithë komunistët marksistë-leninistë edhe ai e konsideron fenë si opium për popullin, dhe ai e sulmon atë jo thjesht me një fjalim apo me një takim, por nëpërmjet hallkave shtetërore të orientuara nga aparatçikët e Komitetit Qendror të PPSH-së. Diskutimet që bëheshin dhe vendimet që merreshin në Komitetin Qendror të PPSH-së i përcilleshin të gjitha hallkave partiake dhe materialet punoheshin në të ashtuquajturat “format” e organizatave bazë të Partisë nëpër qytete, rrethe e qendra pune, kooperativa e ferma bujqësore shtetërore. Për këtë shërbënin edhe një sërë organizatash të tjera shtesë, të cilat konsideroheshin si “rripa transmisioni” të Partisë, si: Fronti Demokratik, Bashkimet Profesionale, Bashkimi i Gruas, Bashkimi i Rinisë me hallkat e veta yllka, fatosa e pionierë etj. Të gjitha këto organizata orientoheshin dhe organizoheshin nga Komiteti Qendror dhe Byroja Politike e PPSH-së, e cila iu jepte direktivat e punës atyre. Anëtarësimi në Frontin Demokratik, Bashkimet Profesionale, Bashkimin e Rinisë ishte gati i detyrueshëm për të gjithë popullsinë. Heqja e “triskës së Frontit” presupozonte heqjen e të drejtave politike, si dhe në shumë raste shpalljen “armik i popullit” të personit. Ky ishte pak a shumë zinxhiri shoqëror i kolektivizimit të popullsisë dhe i politizimit të tejskajshëm të kategorive të ndryshme shoqërore dhe për pasojë më pas për të arritur ta kontrollonte më mirë nëpërmjet këtyre mekanizmave tejet të politizuar “njeriun e ri” dhe “shoqërinë e re socialiste”, që po ndërtohej. Për këtë arsye takimet e Enver Hoxhës në publik, si lideri suprem dhe ideologu kryesor i regjimit, në Komitetin Qendror apo kudo, si dhe fjalimet apo letrat e tij merrnin një forcë akute sipas situatës, e cila dominonte të gjithë aparatit partiak e propagandistik të Partisë.

Portreti i tij u vendos fillimisht në të gjitha institucionet shtetërore e partiake e në shumë vende publike, por bustet e diktatorit dhe fotot e tij filluan të futen jo vetëm në shtëpitë e anëtarëve të PPSH-së; ato u futën edhe në familjet e zakonshme, dhe ata që nuk e kishin një të tillë shiheshin me dyshim nga kryetarët e Frontit nëpër lagje. Ceremonitë e dasmave nisin me urimin për Partinë dhe shokun

Enver dhe mbylleshin po me të njëjtin urim. Prifti e Hoxha në rastet e vdekjeve u zëvendësuan nga kryetarët e Frontit, apo sekretarët e Partisë, apo komisarët, të cilët lexonin një biografi të të vdekurit dhe e mbyllnin fjalën e tyre duke thënë: “Të na rrojë Partia dhe shoku Enver”. Pra, gradualisht u kërkua të zëvendësohej prifti e hoxha me sekretarin e partisë dhe komisarin, e u zëvendësua gati plotësisht pas marsit të vitit 1967, por ishte e vështirë që Partia e Enver Hoxha të zinte vendin e Zotit në zemrat e njerëzve, dhe këtë e nxori më pas në pah koha.

Nga materialet propagandistike të vëna në qarkullim nga PPSH shihet qartë që Enver Hoxha e ka njohur mirë Islamin dhe praktikën e tij. Kështu u nis me spastrimin e klerikëve “tradhtarë”, e më pas vazhdon me të tjerët, që tregohen “të zellshëm”, e më pas ai vazhdon duke i instruktuar kuadrot partiakë, që ata hoxhallarë të cilët punojnë mirë duhen neutralizuar e bllokuar. “Veç këtyre, mund të flitet në mënyrë të veçantë dhe të organizuar me hoxhallarët dhe me priftërinjtë. Ndonjë hoxhe ose prifti që është i mirë, t’i flitet haptazi që të mos tregohet i zellshëm në punën e tij. Çështja është që të neutralizohet sa më shumë puna e tyre.” (hafiz Tahsim Lunikun e Elbasanit është thirrur rregullisht nga organet e Sigurimit të Shtetit dhe i është bërë presion që të mos jepte mësim feje dhe të tërhiqej nga dave)ti)

Një pjesë të madhe të fesë ai e kategorizon te zakonet prapanike dhe paragjykimet fetare, të cilat duhen të shkatërrohen, duke u zëvendësuar me ateizmin shkencor. Kjo duhet të jetë një luftë e vazhdueshme në kuadrin e revolucionit ideologjik, deri sa të largohen nga ndërjegjja e njerëzve zakonet prapanike dhe paragjykimet fetare.

Për Ramazanin dhe Kurbanin ai i instruktonte anëtarët e Sekretariatit të KQ të PPSH të tregohen të shkathët me propagandën e tyre, duke ua shpjeguar njerëzve në formë të thjeshtë dhe duke ua lidhur me anën ekonomike, pra nuk do të jenë në gjendje të punojnë, e do të dobësohen e do të sëmuren po agjëruan. “Të shpjegohet thjesht se, duke mbajtur ramazan, nuk do të kesh fuqi të punosh tokën dhe kjo do të të lërë pa bukë, do të sëmuresh, do të dobësohesh etj. Me këtë shpjegim në qoftë se nuk arrin të bindet sot, do të bindet nesër”. Në fillim duhet punuar me familjet e komunistëve, që e gjithë familja të mos agjërojë, e mund të mbetet vetëm gjyshja. Me plakatin mund të punohet duke i marrë me të mirë e duke i prekur shpirtërisht. “Djali, për shembull, t’i thotë nënës: na moj nënë këta lekë, dhe na bëj diçka të mirë për

të ngrënë, bëma një herë qejfin dhe mos agjëro, mos ki frikë se nuk do të shkosh në xhehenem po s’agjërove. Ka, pra, një sërë metodash që duhen përdorur, po në asnjë mënyrë të mos përdoren metodat administrative.” Po ashtu futja masive nëpër shkollat shtetërore e ateizmit shkencor, krijimi i zakoneve të reja, si dhe shtimi i numrit të festave të ndryshme do të zëvendësojnë pak e nga pak festat fetare, e më konkretisht bajramin e myslimanëve. “Në qoftë se dikush feston ditëlindjen e fëmijës, festën e Republikës, 1 Majin, 28-29 Nëntorin, apo atë të Vitit të Ri, vjen vetvetiu që ai nuk do t’i kujtojë më festat fetare. Kështu, gradualisht, festat fetare do të braktisen. Njeriu i krijon vetë zakonet, dhe te ne janë krijuar tani plot zakone të reja, të cilat zëvendësojnë zakonet e vjetra. Edhe në këtë mënyrë luftohen mbeturinat fetare.”

Kështu në sajë të një presioni të madh politik e shoqëror të krijuar prej kaq vitesh Enver Hoxha vëren, se “feja myslimane” ka mbetur në simbole, dhe këto simbole, pra xhamitë duhet të frekuentohen sa më pak, e kjo mund të favorizohet që kur të rrëzohet ndonjë xhami të mos rindërtohet më apo të rregullohet, si në rastin e Xhamisë së Sulejman pashës në Tiranë, e cila u dëmtua gjatë luftës, por pushteti nuk e lejoi rindërtimin e saj, megjithëse KMSH-ja pati një program mbi rindërtimin dhe rregullimin e xhamive në kryeqytet e gjetkë të dëmtuara nga lufta pas vitit 1945. Po ashtu Enver Hoxha na rrëfen se e ka ndaluar me sukses ndërtimin e xhamive të reja, por edhe të institucioneve të tjera të kultit. “Këtu ne kemi një terren shumë të favorshëm, na mbetet vetëm detyra që, kur rrëzohet ndonjë xhami, të bëjmë çmos që të mos ndërtohet më. Edhe ndërtimi i ndonjë institucioni fetar nuk mund të bëhet pa lejen e komitetit ekzekutiv, domethënë veprohet njëllë si për ndërtimin e shtëpive dhe të çdo institucioni kulturor.” Në këtë drejtim ai vëren, se ka ndihmuar edhe marrja e pasurive të institucioneve fetare, të cilat prej kohësh ishin futur në varësi të buxhetit, që iu ofronte shteti shqiptar. Enver Hoxha e përcakton dhe e përkufizon fenë politikisht, dhe e konsideron si “frenuese” të proceseve përparuese dhe të ndërtimit “të socializmit dhe njerëzimit nuk duhet të besojnë në “ëndërrimet” e një njeriu të shek. VI”. “Ç’lidhje mund të kenë këto ëndërrime të Muhametit me realitetin tonë të shekullit XX? Asnjë lidhje! Prandaj duhen zhdukur përfundimisht dhe pa nishan këto lidhje që e shtrëngojnë njeriun këmbë e duar dhe e poshtërojnë.”

Islami dhe fjala e lirë: ç'është aq për të qeshur?

Sharif Nashashibi

Mbulimi mediatic i vrasjeve në Paris është tipik i incidenteve të mëhershme në Perëndim që përfshijnë Islamin dhe fjalën e lirë. Një pjesë e mirë e tij ka ndërruar drejtim mes shpërudhësës, sensacionales dhe absurdes, siç një "ekspert i terrorizmit" në Foks Njuz (Fox News) që e damkos Birmingemin si një "qytet vetëm musliman".

Gazetarët i janë bashkuar Zhë Sui Sharli-së (Je Suis Charlie). Shumë nuk do ta përlligjinin kurrë përmbajtjen e Sharli Hebdo-së (Charlie Hebdo), e atëherë pse vetidentifikohen me revistën? Vrasja e stafit të saj mund të dënohet pa e përqaftuar atë çka ajo përfaqëson.

Media ngjan ngurruese për t'i hulumtuar shkaqet e radikalizmit që çon në sulme të tilla, sikur të vepruarit kështu nënkupton justifikim. Kësisoj, ka pak diskutim mbi tëhuajtjen muslimane në Francë dhe gjetkë në Europë.

Rezultati është një ligjërim thjeshtëzues mbi Islamin kundër fjalës së lirë. Kjo e fundit është portretizuar në mënyrë naive si absolute dhe e panegociueshme, duke u dhënë kurajë elementëve racistë të shoqërisë kur ndjenja tejet konservatore europiane po rritet.

Islami kundër fjalës së lirë!

Në fakt, çdo e drejtë ka caqe. Liria e shprehjes "është e kufizuar" në Francë "me ligjet e rrepta të shpifjes dhe jetës private" dhe "disa prej ligjeve më të ashpra në Bashkimin Europian mbi gjuhën e urrejtjes", sipas Indeksit mbi Censurën (Index on Censorship).

Në Francë, dhe në shtete të tjera europiane, është krim ta mohosh Holokaustin, por jo gjenocidet e tjera. Muslimanët janë mbikëqyrur në mënyrë të shpërpjestuar. Mbajtja e veshjeve apo shenjave fetare është e ndaluar në shkolla, ashtu siç mbulesa e fytyrës në vendet publike, e faljet islame në rrugë.

Media i ka kaluar përgjithësisht në heshtje ose i ka paraqitur si të pranueshme kufizimet e tilla në Francë dhe në vendet e tjera që pretendojnë shprehje të lirë të pakufizuar.

Po ashtu mungon, edhe pse është e rëndësi të madhe, njohja

e standardeve të dyfishta në përdorimin e fjalës së lirë.

Sharli Hebdo (Charlie Hebdo) e pushoi nga puna një prej punonjësve për përmbajtje anti-semite në materialet.

Ngjashëm me këtë, gazeta daneze Jyllands-Posten deklaroi pak pas botimit të karikaturave të Profetit Muhammed në vitin 2005 se nuk do të botonte karikatura që fyenin kristianët dhe hebrenjtë.

Në dhjetë vite të miat si drejtues i një institucioni mbikëqyrës britanik të medias, është bërë e qartë se muslimanët janë përshkruar shpesh në mënyra përcmuese që janë të papranueshme në lidhje me komunitetet e tjera.

Nuk është trajtuar efekti që ka mbi pakicat, krahasuar me shoqërinë më të gjerë, e drejta për të fyer. Një pakicë që përballet me diskriminimin dhe me privimin nga të drejtat civile ka për t'u ndjerë e kërcënuar në pikëpamjen ekzistenciale, dhe me gjasa do të radikalizohet, kur shumica ushtron të drejtën e vet për të fyer. Gjendja e shoqërinë në përgjithësi nuk është në rrezik kur situata është e kundërta.

Kjo e drejtë është portretizuar si një gur themeli i vlerave perëndimore, ndërsa toleranca dhe respekti, vlera që i kanë tërhequr shumë emigrantë, dhe janë me rëndësi jetike në shoqëritë shumëkulturore, janë nxitur e lëvdur si politika pajtimi.

Ta mbështesësh të drejtën për të fyer pa arsye, pa një ndjenjë përgjegjësie që duhet ta shoqërojë lirinë e shprehjes, është fëmijërore, madje e rrezikshme. Ç'tregohet duke vepruar kështu? Njëparim bazë i gazetarisë është vetëdija se me pushtetin vjen përgjegjësia, por shumë gazetarë në demokraci harrojnë se sa ndikues është profesioni i tyre mbi politikanët dhe opinionin publik.

Marrja e përgjegjësisë

Mendoni mbi efektin te muslimanët të fjalëve të manjatit të medias ndërkombëtare, Rupert Murdokut (Rupert Murdoch), që thotë se ata "duhet të konsiderohen përgjegjës ... derisa ta njohin dhe ta shkatërrojnë kancerin e tyre xhihadist përherë e më të madh".

Kjo pikëpamje është përsëritur nga organet e tij të shumta të

lajmeve, si dhe nga kolegët e panumërt të industrisë, shumë prej të cilëve e kanë përdorur sulmin mbi Sharli Hebdo-në (Charlie Hebdo) për t'i fryrë propagandës për "islamifikimin" e Europës dhe parapambetjen e dhunën e brendaqenësishme të Islamit.

Ata duan që muslimanët t'i dënojnë dhe të kërkojnë ndjesë për akte që as i kanë kryer e as i kanë përlligjur. "Unë dua që muslimanët e vërtetë ta ... bëjnë të qartë si kristali se këta terroristë nuk veprojnë në emër të tyre," shkroi Piers Morgan në një artikull të titulluar, "Nëse unë mund ta pranoj se vrasësit e Parisit nuk janë muslimanë të vërtetë, pse bota muslimane nuk thotë kështu gjithashtu?"

Dënimet me bollëk nga muslimanët të lënë të mendosh se Morgan-i dhe të tjerë ose janë të paditur, ose nuk pranojnë të dëgjojnë.

Ngjashëm çoroditës është konteksti në të cilin është përmendur Islami në lidhje me vrasjet në Paris. Feja e sulmuesve është pjesë përbërëse e përshkrimit të tyre.

Nuk mund të thuhet e njëjta gjë për policin e vrarë, Ahmed Merabet-in, apo për Lasana Batilinë (Lassana Bathily), i cili i shpëtoi blerësit në një supermarket hebre. A është me rëndësi dhe ka lidhje vetëm në një kontekst negativ besimi islam i dikujt?

Ashtu si në të shkuarën, ka më tepër diskutim mbi muslimanët se me ta. Një shembull është programi debatues politik flamurbajtës i BiBiSi-së (BBC), Kuesçën Tajm (Question Time), që kishte në panel pesë persona të cilët flisnin mbi sulmet e Parisit, e asnjë musliman të vetëm.

Mes mbulimit të pandërprerë të vrasjeve, sulmet shpagueuse mbi muslimanët janë lënë në hije, siç janë sulme të tjera vdekjeprurëse ndaj civilëve dhe shtypja e fjalës së lirë në mbarë botën. Incidente të dhunshme javën e fundit në Jemen dhe Nigeri çuan në shumë më tepër vdekje civile se në Paris (gjer në 2000 në Nigeri), por nuk u çmuan të denja për t'u dhënë si lajm.

Pjesë e marshimit të solidaritetit në Paris u bënë dhe armiq të fjalës së lirë dhe të gazetarisë së pavarur. Ata të cilët shpresonin se mjetet

kryesore të informacionit do ta vinin në pah këtë hipokrizi mbetën të zhgënjyer.

Ironia nuk i shkoi kot karikaturoturit të Sharli Hebdo-së (Charlie Hebdo), Bernard Holtrop, i cili tha, "Ne vjellim mbi të gjithë këta njerëz që papritur po thonë se janë miqtë tanë... Duhet të qesh me këtë."

Megjithatë, mbulimi problematik i përsëritur nuk është për të qeshur.

Autori është një gazetar që ka fituar çmime dhe një analist i çështjeve arabe.

*Përzgjedhi dhe përktheu:
Bujar M. Hoxha*

AKTIVITET!

Në datën 17 Janar, Unioni Studentor Musliman me mbështetjen e "Lidhja e Hoxhallarëve të Shqipërisë" organizoi në ambjentet e pallatit të kulturës në qytetin e Durrësit, simpoziumin me temë "Rinia mes sfidave bashkëkohore dhe mesazhit hyjor"

Ne fillim të aktivitetit u shfaq një material filmik mbi disa aspekte gjeografike dhe kulturore të qytetit të Durrësit.

Materiali ndër të tjera përmendte dhe punën heroike në ndërtimin e brezave të rinj të hafiz Ali Podgoricës, i cili ka qenë firmëtar i pavarësisë dhe kryetari i parë i bashkisë në qytetin e Durrësit, si dhe për kontributin e dijetarit tjetër hoxhë Mustafa Varroshi.

Referati i parë ishte i z. Edvin Camit, i cili është dhe pedagog në univesitetin e Durrësit. Ai vuri theksin tek raporti që duhet të ekzistojë midis asaj që koniserohet dije fetare dhe asaj laike.

Referimi i dytë ishte nga Justinian Topulli, kryetar i L.H.SH-së

Z. Topulli foli për dy sfida të rinisë dhe shoqërisë në përgjithësi, për individualizmin dhe materializmin i cili është shtrirë në çdo qelizë të shoqërisë.

Në përfundim foli hoxhë Mustafa Tërniqi, përgjegjësi i hulumtimeve fetare pranë L.H.SH.

Z. Tërniqi solli disa statistika mbi vese të ndryshme të rinisë sot dhe foli se rinia duhet të ketë kujdes mbi aspektet morale dhe ato ideologjike.

Islamofobia, Europa shekullaro-kristiane dhe racizmi

Ibrahim Kallën

S hfaqja e kohëve të fundit e grupeve dhe manifestimeve antiislame anembanë Europës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës po bëhet gjithnjë më shumë një model i përgjithshëm. Me një mori mërish të përziera për një varg çështjesh të ndryshme, pjesa më e madhe e të cilave ka të bëjnë fare pak ose aspak me Islamin dhe muslimanët, grupet ekstremiste dhe tejet konservatore janë përfshirë në një fushatë sistematike për t'i bërë bashkësitë muslimane të pakicës kokë turku për të këqijat shoqërore, ekonomike dhe politike në vendet e tyre në Europë dhe në SHBA. Ata përdorin një imazh të zgjedhur e të shtrembëruar të Islamit dhe kërkojnë të krijojnë një sintezë të veçantë të Perëndimit judeo-kristian dhe shekullar kundër një armiku imagjinar, të quajtur "islamizimi i Perëndimit".

Lëvizja antimuslimane po zhvendoset nga ligjërimit në veprim. Manifestimet e mëdha të organizuara në Drezden të Gjermanisë më 15 dhjetor nga grupi i quajtur PEGIDA (Patriotische Europäer Gegen die Islamisierung des Abendlandes [Europianët Patriotë Kundër Islamizimit të Perëndimit] – shënim i përkthyesit) tërhoqën mijëra njerëz. Slogani i tyre përmban fjalët, "Gjermania nuk është vendi i emigrantëve". Ata u kërkojnë bashkësive imigrante të jetojnë në përputhje me një "kulturë të bazuar në humanizmin" dhe në vlerat "kristiano-hebreje".

Një kërkesë e tillë do të përjashtonte lehtësisht miliona gjermanë vendas, që mbase nuk do të pajtoheshin me përkufizimin e PEGIDA-sit mbi mënyrën e të qenit fetar dhe humanist në Europën e shekullit të njëzet e një. Ironikisht, lëvizjet antimuslimane përdorin argumente kristiane dhe shekullare kundër imigrantëve në përgjithësi, dhe kundër muslimanëve

në veçanti. Në një mënyrë mjaft ogurkeqe, ata i identifikojnë muslimanët si antikristianë, anti-modernë dhe antihumanistë. Grupet fetare dhe shekullare të ekstremit të djathtë në Europë dhe në SHBA, ndërsa nuk janë të një mendjeje për thujtë të tëra çështjet madhore, bashkohen kundër atij çka ato e perceptojnë të jetë kërcënimi i Islamit.

Mbështetësit e PEGIDA-sit në Gjermani e mohojnë se janë racistë apo neonazistë, sido që ca i shohin ata si "neonazistë në vija të holla". Alarmuese është tipologjia e tyre që priret për nga e mesmja: punëtorë krahu, profesionistë të klasës së mesme, prindër, pensionistë, e të tjerë. Këta nuk janë banda apo aktivistë të krahut të djathtë ekstrem, por njerëz të zakonshëm. Dhe pikërisht kjo është e rrezikshme rreth apelit të kësaj vale të re të lëvizjes antiislame dhe antiemigrante. Protestat e mëdha dhe ligjërimit që ata përdorin tregon shkallën në të cilën islamofobia dhe ksenofobia po bëhen të pranueshme shoqërisht mes grupeve të ndryshme në Gjermani.

Fatmirësisht, qytetarët dhe politikanët gjermanë kanë reaguar ndaj kësaj lëvizjeje të re që ngjan gati-gati me racizëm. Kancelarja Angela Merkel u shpreh se, "në Gjermani ka liri të grumbullimit, por nuk ka vend për nxitje dhe gënjeshtër për njerëzit që vijnë tek ne nga vende të tjera". Një kundërmanifestim i madh u mbajt në Këln për të kundërshtuar pikëpamjet raciste të PEGIDA-sit, ku u përsërit pandërprerë slogani antinazist "nie wieda" (kurrë më).

Anëtari i Partisë së Gjellbër në parlamentin gjerman, Ëzhan Mutlu (Özcan Mutlu), vuri në dukje se, "islamofobia është një problem i madh në Gjermani, ashtu si antisemitizmi". Ai gjithashtu shtoi se, "media gjermane nuk e ka marrë deri tani përgjegjësinë

e paralajmërimit të njerëzve mbi islamofobinë".

Këto reagime janë të rëndësishme, por problemi nuk do të zhduket vetëm me deklaratime publike. Vala shoqërore e islamofobisë është e lidhur ngushtë me ngjitjen e partive politike të krahut të djathtë, si Fronti Kombëtar i Francës dhe Agimi i Artë i Greqisë. Fakti alarmues është se këto parti shërbejnë për të normalizuar dhe legjitimuar atë çka normalisht do të quhej e ndaluar në një rend demokratik.

Sulmet antimuslimane po bëhen të shpeshta jashtë Gjermanisë. Një xhamie të vogël iu vu zjarri më 25 dhjetor në qytetin suedez të Eskilstunës, rreth 90 kilometra në perëndim të Stokholmit, dhe pesë persona u lënduan. Kjo ngjarje pasoi një tjetër incident, të ndodhur në janar, kur në derën kryesore të një xhamie në Stokholm u vizatuan kryqet të thyer.

Në Norvegji, vrasësi i dënuar Anders Breivik, i cili vrau 77 njerëz pas një sulmi të çmendur më 2011 për të "shpëtuar Europën nga Islami", po kërkon nga sa thuhet, sipas autoriteteve norvegjeze, të krijojë një rrjet fashistësh të një mendjeje duke shkruar qindra letra nga qelia e tij e burgut.

Në Francë, gazetari francez Erik Zémur (Éric Zemmour) kërkoi të argumentojë se pse duheshin përzënë pesë milionë muslimanët e vendit. Duke folur për gazetën italiane Corriere Della Serra, ai deklaroi se muslimanët priren të izoloohen në rrethina dhe të jetojnë me njëri-tjetrin, me parashikimin që kjo çon në fund në "kaos dhe luftë civile". Ministri francez i Punëve të Brendshme, Bernard Cazeneuve (Bernard Cazeneuve), i dënoi deklaratat e Zemurit (Zemmour).

Matanë Atlantikut, Abdisamed Shejh-Husein (Abdisamad Sheikh-Husseïn), një pësëmbëdhjetëvjeçar musliman

somalez, vdiq më 4 dhjetor, kur, sipas policisë së qytetit të Kansasit, ai u godit me dashje nga një makinë që ia këputi të dy këmbët. Shoferi ishte i njohur për kërcënimet ndaj muslimanëve në qytet. Kërcënimet e tij i morën jetën në fund një djali në një sulm burracak dhe barbar.

Nuk është e vështirë t'i amplifikosh shembujt e tillë. Është e vërtetë se çdonjë prej këtyre është një rast më vete. Por kjo është pikërisht ajo që kërkon vëmendje: kaq shumë sulme të ndryshme, në kaq vende të ndryshme, janë kryer me motive të ngjashme. Ato janë përsëritur me një shpeshësi në rritje, duke krijuar një atmosferë frike dhe kanosjeje.

Është gabim fatal t'i demonizosh bashkësitë e pakicave muslimane në emër të mbrojtjes së identitetit shekullar dhe judeo-kristian të vendeve perëndimore. Nëse mund të bëhet një përkufizim i tillë i kulluar i identitetit në jetën reale është shumë më tepër e ndërlikuar nga ç'dëshirojnë neoracistët të na bëjnë të besojmë.

Ne duhet të jemi syhapur ndaj këtyre fushatave urretjeje dhe racizmi. Njerëzit e vetëdijshëm me tradita fetare dhe të shkuar kulturore të ndryshme duhet të jenë në gjendje të bashkohen kundër grupeve antiislame dhe ksenofobe. Kjo është mënyra se si duhen çmuar e ushqyer vlerat fetare dhe humaniste për të cilat ne të tërë mund të aspirojmë.

Autori është zëdhënësi i presidentit të Republikës së Turqisë, Rexhep Tajip Erdogan (Recep Tayyip Erdoğan)

*Përzgjedhi dhe përktheu:
Bujar M. Hoxha*



Bar Restorant Piceri "Ishulli Luanëve"

Në dalje të Tiranës, larg zhurmave të përditshme, në qetësinë dhe në ajrin e pastër, do të shijoni gatime tradicionale dhe hallall të guzhinës sonë.

Menu e pasur dhe një pamje piktoreske e lumit Erzen, e cila do t'ju mahnisë.

Ju mirëpresim!



**Adresa: Rruga nacionale
Tiranë-Durrës, Ndroq, km 17**

Mobile: 00355 682153105

PRODUKTE NATYRALE

Produkte bimore të cilësisë më të mirë nga vendet e Lindjes!



**Adresa: Rr. e Kavajës,
rrugica përballë
xhamisë "Dine Hoxha", Tiranë
Cel: 0672812607 / 0672821589**

Produkte të firmës "Phenomenal", vaj të farës së zezë
Mjaltë me polen, mjaltë sidri, etj.
Hurra arabie të freskëta dhe ujë zemzemi
Kremra të ndryshëm të firmës "Orchid" dhe vajra bimore "Tact"
Shampo bimore "Touch Me" nga Tajlanda
Parfume vajore (3 ml) me aroma të llojlojshme
Parfume me mbushje të markave më të njohura europiane
Misvak dhe pastë dhëmbësh me misvak
Këna bimore 100% natyrale për flokë dhe për duar
Kohël bimor për sytë etj.

**www.produktenatyrale.com
Email: agimballa@hotmail.com**

